



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 623-22-8414-1-3-6/C418

Emri i Autoritetit Kontraktues: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: "ANEA" SH.P.K., Avdulla Bugari p.n., Rahovec, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Titulli i Kontratës: FURNIZIMI DHE MONTIMI I DYERVE NË SHKOLLAT

Me numër identifikues: 623-22-8414-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Furnizimi dhe montimi i dyerve në shkollat, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: datën e nënshkrimit dhe përfundon për një periudhë prej 60 ditë

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 3-5 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: NË SHKOLLAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP² (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 7,965.00 Euro;

[Shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetepesë Euro e zero Cent]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për...muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % e vlerës së kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: 90 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]³ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Bejtulla Mashuku
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	06.10.2022	Data:	06.10.2022
Vula:		Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Objekti: Ndërimi i dyerve të klasave në SHFMU: "ISA BOLETINI"
Vendi : RAHOVEC KK Rahovec

Nr.	Punët e dyerve	Njësia	Sasia	Çmimi/€	Shuma/€
1	Furnizimi dhe montimi i dyerve për dhomat e mësimit, nga druri Diapan i klasit të parë. Kornizat nga druri /Rami/ të jenë nga të jenë kualitative. Dorëza dhe mekanizmi duhet të jenë kualitative .Dera duhet të ketë cilindër adekuat dhe tri kopje qelsash. Vrejte: në çmim të përfshihet Demontimi i dyerve të vjetra, finalizimi i këndeve përreth dyerve të cilat dëmtohen gjatë punës. Vrejte operatori ekonomik që është fitues i tenderit duhet paparakisht të bëjë matjen e sakt të dyerve dhe të përcaktohet për ngjyren e derës.				
1.1	Korniza 200.05x44.5x98 cm	copë	10	120.000	1,200.00
	Korniza 200.05x44.5x85 cm	copë	1	115.000	115.00
	Tabëll dere nga Diapani 200.05x98cm	copë	10	90.000	900.00
1.2	Tabëll dere nga Diapani 200.05x86cm	copë	1	80.000	80.00
				Gjithsej :	2,295.00

Objekti: Ndërimi i dyerve të klasave në SHML: "UKSHIN HOTI"
Vendi : -KRUSHE E MADHE

Nr.	Punët e dyerve	Njësia	Sasia	Çmimi/€	Shuma/€
1	Furnizimi dhe montimi i dyerve për dhomat e mësimit, nga druri Diapan i klasit të parë Kornizat metalike /Rami/ të jenë nga lamarina e galvanizuar-zinkuar. Dorëza dhe mekanizmi duhet të jenë kualitative .Dera duhet të ketë cilindër adekuat dhe tri kopje qelsash. Vrejte: në çmim të përfshihet Demontimi i dyerve të vjetra, ngjyrosja e kornizave, finalizimi i këndeve përreth dyerve të cilat dëmtohen gjatë punës. Vrejte operatori ekonomik që është fitues i tenderit duhet paparakisht të bëjë matjen e sakt të dyerve dhe të përcaktohet për ngjyren e derës.				
1.1	Korniza metalike 198x96x20 cm	copë	2	130.000	260.00
1.2	Korniza metalike 192x83x20 cm	copë	5	130.000	650.00
1.3	Korniza metalike 198x96x25 cm	copë	1	130.000	130.00
1.4	Tabëll dere nga Diapani 198x96x20 cm	copë	2	90.000	180.00
1.5	Tabëll dere nga Diapani 192x83x20 cm	copë	3	80.000	240.00
1.6	Tabëll dere nga Diapani 192x83x20 cm	copë	1	80.000	80.00
1.7	Tabëll dere nga Diapani 196x90x20 cm	copë	3	80.000	240.00
1.8	Tabëll dere nga Diapani 196x90x25 cm	copë	2	80.000	160.00
1.9	Tabëll dere nga Plastika 200x70x5 cm	copë	6	130.000	780.00
				Gjithsej :	2,720.00



Objekti: Ndërimi i dyerve të klasave në SHMLP: "SELAJDIN MULLAABAZI MICI"
Vendi : Rahovec- KK Rahovec

Nr.	Përshkrimi i Punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/€	Shuma/€
1	Demontimi i dyerve të vjetra ekzistuese dhe bartja e lyra deri ne deponin më të afërt. Velëfurnizimi dhe vendosja e dyerve të Blinduara me dim.100x203cm. Të bëhet lyerja për rrethë këndeve të dyerve me llaq qimentoje dhe ngjyrosja për rreth dyerve me polikolor me nuanc si ajo ekzistuese.Vrejtye operatori ekonomik që është fitues i tenderit duhet paparakisht të bëjë matjen e sakt të dyerve dhe të përcaktohet për ngjyren e derës.	copë	3	200.000	600.00
Gjithsej :					600.00

Objekti: Ndërimi i dyerve të klasave në SHML: "12 MAJI"
Vendi : -RATKOC

Nr.	Punët e dyerve	Njësia	Sasia	Çmimi/€	Shuma/€
1	Furnizimi dhe montimi i dyerve për dhomat e mësimt,nga druri mediapan i klasit të parë me trashësi 40mm me pllaka mediapani nga 8mm në të dy anët dhe profile druri në brendësi.Dera duhet të jetë e mbështjellur nga foli çka e bënë derën e rezistueshme nga lagështia dhe gërvishjet e lehta.Dera duhet të jetë e pajisur është me 3 mëntesha(bagllam). Vrejtye operatori ekonomik që është fitues i tenderit duhet paparakisht të bëjë matjen e sakt të dyerve dhe të përcaktohet për ngjyren e derës.				
1.1	Dimensionet e deres 1mx2.10m	copë	20	80.000	1,600.00
Gjithsej :					1,600.00

e Përgjje
SH.P
AN
RAHC

Objekti: Riparimi salles se arsimtarve në SHFMU "HAMËZ THAÇI"
Vendi : Xërxe -KK Rahovec

Nr.	Pershkrimi i Punëve	Njësia	Sasia	Çmimi/€	Shuma/€
1	Shtuarja (montimi) e dyshemes me laminat të klasit AC4 32 Vint.10mm,si dhe vendosja e lajsneve në tërë perimetrin e sallës.Vrejtye operatori ekonomik që është fitues i tenderit duhet paparakisht të bëjë matjen e sakt të sallës së arsimtarve dhe të përcaktohet për ngjyren e laminatit	m ²	50	15.000	750.00
Gjithsej :					750.00

RAHOC
SH.P
AN
RAHC

REKAPITULLIMI		
I	SHKOLLA FILLORE "ISA BOLETINI" NE RAHOVEC	2,295.00 €
II	SHKOLLA MESME "UKSHIN HOTI" NE KRUSHE TE MADHE	2,720.00 €
III	SHKOLLA MESME "SELAJDIN MULLABAZI MICI" RAHOVEC	600.0 €
IV	SHKOLLA MESME "12 MAJI" NE RATKOC	1,600.00 €
V	SHKOLLA FILLORE "HAMEZ THACI" NE XERXE	750.0 €
TOTAL I		7,965.00 €

